



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3328 / Prot.  
13

Patos më 05.04 /2024



Miratohet  
Kryetari  
Faton Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 29, datë 05.04.2024

**MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS “SHËN TRIFONI” DHE “SHËN SOTIRI”, SHEQISHTE**

Në zbatim të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe planit të përgjithshëm vendor, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 04/12/2020 ku specifikohen zonat me rëndësi kombëtare, si pjesë e trashëgimisë kulturore janë evidentuar Manastiri i “Shën Trifonit” dhe Kisha e “Shën Sotirit” në fshatin Sheqishte. Kërkesës me nr. 3328 prot., datë 12/12/2023 për financimin e projektit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”.

Shkresës nr. 3328/1 prot., datë 13/03/2024 në të cilën është konfirmuar miratimi i financimit të projektit të aplikuar nga ana e kompanisë Bankers Petroleum.

Ekipi i programit të menaxhimit në kuadër të finalizimit me sukses të këtij aplikimi për të vazhduar me procedurat e mëtejshme të implementimit të projektit,

**KËRKON:**

1. Miratimin e projekt-vendimit për projektin “Rikonstruksionin e rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”, Sheqishte me vlerë 9,644,278.57 lekë me tvsh (përfshirë mbikqyrje dhe kolaudim).

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Ermenita MICI

Gazmira PLESATI

Silvana MICI

Marsilda LIZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS

Nr. 3328 / Prot.

Patos më, 05/04/2024

**RELACION PËR PROJEKT-VENDIM**

***PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS "SHËN TRIFONI" DHE "SHËN SOTIRI", SHEQISHTE***

Referuar planit të përgjithshëm vendor, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 04/12/2020, ku specifikohen zonat me rëndësi kombëtare si pjesë e trashëgimisë kulturore, dallojmë Manastrin e "Shën Trifonit" dhe Kishën e "Shën Sotirit", të evidentuara si objekte me rëndësi kulturore-fetare në territorin e Bashkisë Patos.

Nga ana tjetër me qëllim përmisimin e infrastrukturës rrugore dhe krijimin e kushteve sa më të favorshme për levizjen e banorëve është hartuar projekti për rikonstruksionin e rrugës "Shën Trifoni" dhe "Shën Sotiri", të cilat i mundësojnë banorëve dhe besimtarëve të shumtë aksesin drejt kulteve fetare.

Gjendja aktuale e rrugëve është në kushte jo të mira për shkak të mungesës së ndërhyrjeve prej vitesh në këto segmente, duke u bërë dhe problematike për banorët e zonës dhe një kërkesë e domosdoshme për ndërhyrje në rehabilitimin e tyre.

Rrugët, të cilat do të nënshtrohen rikonstruksionit ndodhen në Fshatin Sheqishte. Rruga "Shën Trifoni" fillon që nga pikë-takimi i rrugëve "Shën Mëria" me rrugën "Këneta e Mitros" dhe vazhdon për rreth 575 m deri në Kishën e "Shën Trifonit". Rruga "Shën Sotiri" ka gjatësi rreth 447 m dhe lidh rrugën Shën Trifoni me kishën e "Shën Sotirit". Në total gjatësia e rrugëve që kërkohet të rehabilitohen është 1022 ml.

Referuar situatës së mësipërme ndërhyrja për rikonstruksionin e këtyre rrugëve shikohet si një domosdoshmëri për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme për të gjithë zonën.

Bashkia Patos ka hartuar projektin e rikonstruksionit të këtyre 2 segmenteve rrugore, ku përfshihet rehabilitimi i karrexhatës së rrugës me paketën e shtresave të nevojshme. Vlera e projektit është 9,644,278.57 lekë me tvsh (duke përfshirë mbikqyrje dhe kolaudim). Financimi i projektit do të mundësohet nga kompania Bankers Petroleum të cilët kanë shprehur miratimin e financimit të investimit me anë të shkresës nr. 3328/1 prot., datë 13/03/2024, në vijimësi të bashkëpunimeve të sukseshme të mëparshme të realizuara për projekte të ndryshme.

**Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:**

1. Miratimin e projekt vendimit për projektin “Rikonstrukcion i rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”, Sheqishte.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Ermenita MICI



Gazmira PLESATI



Silvana MICI



Marsilda LIZAJ

